



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË
PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE
INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 3949 Prot.

Tiranë, më 1.11.2021

UDHËZIM

Nr.927, Datë 1.11.2021

PËR

MËNYRËN DHE PROCEDURËN E PLOTËSIMIT TË DEKLARATAVE TË
PASURISË DHE INTERESAVE PRIVATË NË FORMË ELEKTRONIKE NË
SISTEMIN ELEKTRONIK PËR DEKLARIMIN E PASURIVE DHE
KONFLIKTIT TË INTERESIT (EACIDS)

Në mbështetje të nenit 4/2, nenit 15, nenit 16/1, nenit 17, 21, 22, 34/2 dhe nenit 42/2, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 330, datë 22.4.2020 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore ‘Sistemi i deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesit – EACIDS’”,

UDHËZON:

I. Preambul

1. Sistemi i deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesit – (EACIDS) është një sistem informacioni, i zhvilluar për menaxhimin e procesit të deklarimit të interesave privatë dhe konfliktit të interesit nga subjektet që mbartin detyrim për deklarim, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Ky sistem menaxhon regjistrin e Autoriteteve Përgjegjëse, regjistrin e subjekteve deklaruuese dhe personave të lidhur, deklaratat e interesave privatë, si dhe proceset e brendshme të punës në ILDKPKI, në lidhje me administrimin e deklaratave të dorëzua, verifikimin dhe kontrollin e saktësisë së të dhënave të deklaruara, bazuar në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar dhe ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

II. Subjektet ndërvepruese me bazën e të dhënavë EACIDS

2. Përdoruesit që do të ndërveprojnë me sistemin EACIDS, për të paraqitur dhe/ose për të administruar të dhënat, janë:
 - a) ILDKPKI;
 - b) Autoritetet Përgjegjëse për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në institucionet publike;
 - c) Subjektet deklarues që mbartin detyrim për deklarimin e pasurisë dhe interesave privatë në ILDKPKI;
 - d) Institucionet publike dhe private për dhënie informacioni në funksion të kontrollit të plotë dhe hetimit administrativ.
3. ILDKPKI është përgjegjës për krijimin, mirëmbajtjen, administrimin e bazës së të dhënavë “Sistemi i Deklarimit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit — EACIDS”, dhe për ndërveprimin e përbajtjes së tij me bazat e tjera të informacionit.
4. Autoriteti Përgjegjës për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në çdo institucion publik është struktura përgjegjëse, e cila ndjek në vazhdimësi procesin e deklarimit të pasurisë dhe interesave privatë, për të gjithë zyrtarët e institucionit publik përkatës, duke hartuar dhe përditësuar listën e zyrtarëve, të cilët në varësi të funksionit që kryejnë, mbartin detyrimin për deklarim të interesave privatë. Autoriteti Përgjegjës menaxhon procesin e deklarimit në sistem të subjekteve deklaruese, sipas legjislacionit në fuqi dhe këtij udhëzimi.
5. Autoriteti Përgjegjës për Parandalimin e Konfliktit të Interesave ushtron këto funksione dhe detyra në përdorimin e sistemit:
 - a) Krijon llogarinë fillestare dhe/ose menaxhon llogaritë e subjekteve që mbartin detyrimin për deklarim të interesave privatë në institucionin përkatës;
 - b) menaxhon tipin e deklaratave që duhet të plotësojë subjekti deklarues;
 - c) rivendos fjalëkalimin për çdo subjekt deklarues kur është e nevojshme ose me kërkesë të subjektit deklarues;
 - ç) realizon çaktivizimin e llogarisë së subjektit deklarues, në të cilën subjekti e ruan aksesin, por vetëm në variantin e lexueshëm;
 - d) përgatit raporte të përgjithshme vjetore për subjektet deklaruese gjatë vitit kalendarik me të dhëna statistikore, si dhe sa herë kërkohet një gjë e tillë nga Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI;
 - dh) menaxhon deklarimin elektronik të konfliktit të interesit;
 - a) ndihmon kryesisht ose sa herë që i kërkohet nga subjektet deklaruese, për deklarimin e plotë dhe korrekt në sistem të pasurisë dhe konfliktit të interesave të subjekteve deklaruese, si dhe bashkëpunon ngushtësisht me ILDKPKI për realizimin me sukses të këtij procesi;
 - ë) përditëson (shton/fshin/çaktivizon) listën e funksioneve që kanë detyrim për deklarim të interesave privatë në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

6. Kryerja e detyrate të Autoritetit Përgjegjës, sipas përcakttimeve të seksionit III të këtij udhëzimi në lidhje me procedurën e deklarimit, bëhet në përputhje me manualet përkatës të përdorimit të sistemit elektronik të deklarimit të pasurive dhe konfliktit të interesave (EACIDS), të cilët janë pjesë integrale e këtij udhëzimi, si dhe me çdo udhëzim tjetër të dhënë nga Inspektori i Përgjithshëm.
7. Subjektet deklaruese:
 - a) Menaxhojnë llogaritë e tyre në sistemin EACIDS;
 - b) mbajnë përgjegjësi për aprovimin e versionit përfundimtar brenda afateve të përcaktuara në ligj e në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe përcaktimet e këtij udhëzimi;
 - c) dorëzojnë të nënshkruar, në formë shkresore, deklaratën e interesave privatë të përfunduar pranë Autoriteteve Përgjegjëse;
 - ç) bashkëpunojnë e konsultohen me Autoritetin Përgjegjës në lidhje me procedurën e deklarimit në sistemin EACIDS.
 - d) bashkëpunojnë me ILDKPKI, gjatë procedurave të kontrollit të plotë dhe/ose hetimit administrativ.
8. Subjektet deklaruese duhet të plotësojnë deklaratat e interesave privatë përkatëse, sipas mënyrës dhe afateve të mëposhtme:
 - a) Subjektet të cilët mbartin detyrimin ligjor të bëjnë deklarimin periodik vjetor të interesave privatë dhe konfliktit të interesave për vitin 2021, duhet të plotësojnë deklaratën e interesave privatë periodike vjetore në formë elektronike për subjektet në funksion, për pasuritë e akumuluara ndër vite dhe detyrimet financiare me gjendje **në 31.12.2021**, si dhe burimin e krijimit të tyre. Deklarata e interesave privatë periodike vjetore në formë elektronike, për subjektet në funksion, duhet plotësuar dhe dorëzuar brenda datës **31 mars 2022**, si vilon:
 - **në formë elektronike**, duke kryer plotësimin dhe aprovimin e versionit përfundimtar të deklaratës në sistemin EACIDS, të vënë në dispozicion nga ILDKPKI, dhe;
 - **në formë shkresore**, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, deklarata e plotësuar në formë elektronike duhet printuar e nënshkruar në çdo fletë të saj, sipas rubrikave përkatëse dhe dorëzohet e myllur në zarf, pranë Autoritetit Përgjegjës të institucionit publik.
 - b) Subjektet të cilët fillojnë marrëdhënet e punës pas datës 1 janar 2022, mbartin detyrimin të bëjnë deklarimin para fillimit të detyrës dhe duhet të kryejnë deklarimin në sistemin elektronik EACIDS, brenda 30 ditëve nga fillimi i detyrës, në përputhje me afatet e përcaktuara në ligj, si vilon:
 - **në formë elektronike**, duke kryer plotësimin dhe aprovimin e versionit përfundimtar të deklaratës në sistemin EACIDS, të vënë në dispozicion nga ILDKPKI, dhe;
 - **në formë shkresore**, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, deklarata e plotësuar në formë elektronike duhet printuar e nënshkruar në çdo fletë të saj, sipas rubrikave përkatëse dhe dorëzohet e myllur në zarf pranë Autoritetit Përgjegjës të institucionit publik.

- c) Subjektet të cilët mbartin detyrimin ligjor të bëjnë deklarimin periodik vjetor të interesave privatë dhe konfliktit të interesave, duhet të kryejnë deklarimin në sistemin EACIDS, brenda datës **31 mars të çdo viti**, në përputhje me afatet e përcaktuara në ligj, si vijon:
- **në formë elektronike**, duke kryer plotësimin dhe aprovimin e versionit përfundimtar të deklaratës në sistemin EACIDS, të vënë në dispozicion nga ILDKPKI, dhe;
 - **në formë shkresore**, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, deklarata e plotësuar në formë elektronike duhet printuar e nënshkruar në çdo fletë të saj, sipas rubrikave përkatëse dhe dorëzohet e mbyllur në zarf, pranë Autoritetit Përgjegjës të institucionit publik.
- d) Subjektet të cilët largohen nga detyra pas datës 1 janar 2022, mbartin detyrimin të bëjnë deklarimin pas largimit nga funksioni dhe duhet të kryejnë deklarimin në sistemin elektronik EACIDS, brenda 15 ditëve nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës, në përputhje me afatet e përcaktuara në ligj, si vijon:
- **në formë elektronike**, duke kryer plotësimin dhe aprovimin e versionit përfundimtar të deklaratës në sistemin EACIDS, të vënë në dispozicion nga ILDKPKI, dhe;
 - **në formë shkresore**, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, deklarata e plotësuar në formë elektronike duhet printuar e nënshkruar në çdo fletë të saj, sipas rubrikave përkatëse dhe dorëzohet e mbyllur në zarf, pranë Autoritetit Përgjegjës të institucionit publik.
- e) Kandidatët që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë dhe interesave privatë për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë, duhet të plotësojnë deklaratën e pasurisë dhe interesave privatë të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë, në përputhje me afatet dhe parashikimet ligjore në fuqi, si më poshtë vijon:
- **në formë elektronike**, duke kryer plotësimin dhe aprovimin e versionit përfundimtar të deklaratës në sistemin EACIDS, të vënë në dispozicion nga ILDKPKI, dhe;
 - **në formë shkresore**, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, deklarata e plotësuar në formë elektronike duhet printuar e nënshkruar në çdo fletë të saj, sipas rubrikave përkatëse dhe dorëzohet e mbyllur në zarf, pranë Autoritetit Përgjegjës të institucionit publik, apo nëse parashikohet në ligj pranë ILDKPKI.
- f) Subjektet të cilët mbartin detyrimin ligjor të bëjnë deklarimin me kërkësë të interesave privatë, duhet të plotësojnë deklaratën e interesave privatë me kërkësë, në formë elektronike, në sistemin EACIDS, jo më vonë se 30 ditë nga data që Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI kërkon kryerjen e deklarimit me kërkësë, në përputhje me afatet dhe parashikimet ligjore në fuqi, si vijon:
- **në formë elektronike**, duke kryer plotësimin dhe aprovimin e versionit përfundimtar të deklaratës në sistemin EACIDS, të vënë në dispozicion nga ILDKPKI, dhe;

- **në formë shkresore**, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, deklarata e plotësuar në formë elektronike duhet printuar e nënshkruar në çdo fletë të saj, sipas rubrikave përkatëse dhe dorëzohet e mbyllur në zarf, pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

III. Procedura e deklarimit të pasurisë dhe interesave privatë nëpërmjet bazës së të dhënave EACIDS

9. Autoriteti Përgjegjës për Parandalimin e Konfliktit të Interesave regjistron në sistemin EACIDS të dhënat e subjektit deklarues dhe personave të lidhur me të, në përputhje me fushat e kërkua e menyrës së përcaktuar në manualet e përdorimit të sistemit.
10. Me regjistrimin e zyrtarit si subjekt deklarues, sipas pikës 5 të udhëzimit, në sistemin EACIDS krijohet llogaria e tij, duke i gjeneruar emër përdoruesi dhe fjalëkalim.
11. Autoriteti Përgjegjës për Parandalimin e Konfliktit të Interesave njofton me shkresë zyrtare subjektin deklarues për llogarinë e hapur brenda 48 orëve nga kriimi i saj, duke i komunikuar emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin që duhet të përdorë në llogarinë e tij.
12. Subjekti deklarues, krahas njoftimit me shkresë sipas pikës 11, merr njëkohësisht edhe një komunikim elektronik (email) në adresën e njoftuar prej tij/saj, pranë Autoritetit Përgjegjës, në të cilin i komunikohet emri i përdoruesit dhe fjalëkalimi i llogarisë, me të cilat kryen hyrjen e parë në sistemin EACIDS.
13. Subjekti deklarues, që kryen hyrjen për herë të parë në llogarinë e tij në sistemin EACIDS, duhet të bëjë ndryshimin e fjalëkalimit të dhënë me një fjalëkalim të zgjedhur prej tij. Fjalëkalimi duhet të jetë minimalisht me 6 karaktere, si dhe duhet të përbajë një kombinim të shkronjave kapitale dhe të vogla, numrave dhe karaktereve speciale si; (!, @, #, etj.);
14. Plotësimi, ndryshimi, korrigimi i llojit të deklaratës së pasurisë dhe interesave privatë, dhe në përgjithësi menaxhimi i llogarisë së subjektit deklarues, bëhet elektronikisht dhe është përgjegjësi e vetë subjektit deklarues. Veprimet e përshkruara në këtë pikë mund të kryhen për sa kohë subjektet nuk kanë aprovuar versionin përfundimtar të deklaratës në sistemin elektronik. Pas aprovimit të versionit përfundimtar subjekti mund të aksesojë vetëm variantin e lexueshëm dhe nuk mund të kryejë më veprime mbi deklaratën e dorëzuar në menyrë elektronike.
15. Deklarata e interesave privatë e përfunduar nëpërmjet sistemit elektronik, nuk do të konsiderohet e dorëzuar me aprovimin e versionit përfundimtar dhe ngarkimin në sistemin elektronik EACIDS. Subjektet deklaruese, në mbështetje të legjislacionit në fuqi, për çdo vit bëjnë dorëzimin e deklarimit periodik vjetor, dhe kur është rasti, deklarimin para fillimit të detyrës, deklarimin pas largimit nga funksioni, deklarimin me kërkesë dhe deklarimin e pasurisë dhe interesave privatë të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë, duke e printuar, nënshkruar në çdo faqe dhe dorëzuar në formë shkresore në Autoritetin Përgjegjës të

Parandalimit të Konfliktit të Interesave, sipas afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar.

IV. Dispozita të fundit

16. Autoritetet Përgjegjëse duhet të kryejnë në mënyrë efektive detyrat e tyre sipas dispozitave ligjore në fuqi, këtij udhëzimi, si dhe manualeve për përdorimin e sistemit EACIDS, që janë pjesë integrale e këtij udhëzimi.
17. Nëse Autoritetet Përgjegjëse në kohën e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi kanë në përbërje të tyre vetëm një nëpunës dhe kur numri i subjekteve deklaruese në këtë institucion është më i madh se 50 subjekte, titullari i institucionit brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, emëron me shkrim, në detyrën e nëpunësit të dytë të Autoritetit Përgjegjës, një punonjës pjesë të drejtorisë/sektorit të Burimeve Njerëzore ose, në mungesë, një punonjës tjetër të institucionit me formim jurist.
18. Një kopje e urdhrit të titullarit të institucionit për emërimin e nëpunësit, sipas pikës 17 të këtij Udhëzimi, i dërgohet ILDKPKI-së.

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM



Ergjeni BASHARI